

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëseve: A.G. dhe L.SH. nga Prishtina, të cilat i përfaqëson S.N., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar I.H., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses së autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1869/11 i datës 16.12.2015, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 20.06.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1869/11 i datës 16.12.2015, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadsisë për fitimin e humbur, për paditësen A.G. dhe për shpenzimet e shërimit për paditësen: A.G. dhe L.SH. si dhe në pikën III, në pjesën e kërkesës për shpenzimet e procedurës, VERTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1869/11, i datës 16.12.2015, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadsisë, për kompensimin e dëmit jomaterial, për paditëset A.G. dhe L.SH. edhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike, frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, që paditësve: A.G. dhe L.SH. nga Prishtina, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 19.05.2011, ti paguaj shumën e specifikuar dhe atë:

- Paditëses: A.G.: për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 4.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3.500 € dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 16.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadsisë, përtej shumës së gjykuara për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

- Paditëses: L.SH.: për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 5.000 €, për frikën e përjetuar shumën prej 4.000 € dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 18.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadsisë, përtej shumës së gjykuara për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës

Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1869/11, i datës 16.12.2015, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën e gjykuar ashtu që: DETYROHET e paditura që paditësve t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 16.12.2015, e deri në pagesën definitive.

IV. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1869/11 i datës 16.12.2015, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: Pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditëseve A.G. dhe L.SH. nga Prishtina dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Insig" në Prishtinë, që paditëseve në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut i cili ka ndodh me datë 19.05.2011, t'ua paguaj dhe atë: Paditëses A.G., për dhembje fizike shumë prej 12.000 €, për frikën e përjetuar shumë prej 10.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 27.000 €, për shpenzime të shërimit shumë prej 931,80 €. Paditëses L.SH., për dhembje fizike shumë prej 14.000 €, për frikën e përjetuar shumë prej 10.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 35.000 €, për shpenzimet e shërimit shumë prej 1.282 €, në emër të fitimit të humbur për pagat e munguara për periudhën prej datës 20.05.2011 deri me datë 31.07.2012 shumë prej 4.539,87 €, të gjitha me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke iu llogaritur nga data 26.11.2015 e deri në pagesën definitive. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara dhe atë: për paditësen A.G. në emër të dhembjeve fizike mbi shumë 12.000 € deri në 15.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor mbi shumë 27.000 € deri në 30.000 € si dhe në emër të shpenzimeve të shërimit mbi shumë 931,80 € deri në 1.457,40 € si dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën paditësja ka kërkuar që për ushqim të përforcuar t'ia paguaj shumë prej 500 € dhe për përkujdesje nga ana e personit të tretë shumë prej 500 €, për paditësen L.SH. për dhembje fizike mbi shumë 14.000 € deri në 15.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor mbi shumë 35.000 € deri në 40.000 €, në emër të shpenzimeve të shërimit mbi shumë 1.282 € deri 2.701 € si dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën paditësja ka kërkuar që në emër të ushqimit të përforcuar t'ia paguaj shumë prej 700 € dhe në emër të përkujdesjes nga ana e personit të tretë shumë prej 600 €. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Insig" në Prishtinë, që paditëseve shumat e gjykuara në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.301 € t'ua paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim nën kërcënim të përmbarrimit forcërisht.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të

gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën, ndryshoj vendimin gjyqësor ose lëndën ta kthej në rigjykim.

Ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës ju është dorëzuar të autorizuarit të paditëseve. I njëjti me përgjigje në ankesë ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që ankesën e ushtruar nga pala e paditur ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kurse aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj si të bazuar dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 22.08.2011, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, të cilën e kanë precizuar si në parashtresën e datës 26.11.2015, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar që të: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve A.G. dhe L.SH. nga Prishtina dhe Detyrohet e paditura: Kompania e Sigurimeve “Insig” në Prishtinë që paditëseve në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material të cilin e kanë pësuar për shkak të lëndimeve të marra në aksidentit e komunikacionit të datës 19.05.2011 dhe atë: A.G.t, a). Në emër të dëmit jomaterial t’ia paguaj: për dhembjet fizike shumë prej 15.000 €, për frikën e pësuar shumë prej 10.000 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 30.000 €, b). Në emër të dëmit material: Për ushqim të përforcuar shumë prej 500 €, për përkujdesje të personit të tretë shumë prej 500 € si dhe për shpenzime të shërimit shumë prej 1.457,40 €, L.SH., a). Në emër të dëmit jomaterial t’ia paguaj: për dhembjet fizike shumë prej 15.000 €, për frikën e pësuar shumë prej 10.000 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 40.000 €, b). Në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar shumë prej 700 €, për përkujdesje të personit të tretë shumë prej 600 € si dhe për shpenzimet për shërim shumë prej 2.701 €, për fitimin e humbur në emër të pagave të munguara për periudhën prej datës 20.05.2011 deri me datën 31.07.2012 shumë prej 4.040,67 €, me kamatë në shumë prej 499,20 € në shumë të përgjithshme prej 4.539,87 €, të gjitha këto me kamatë prej 12% konform nenit 382 paragraf 2 të LMD-së, që nga data 22.08.2011 kur është ngrit padia e deri me pagesën definitive. II. Detyrohet e paditura që paditëseve shumat e cekura në pikat paraprake të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës t’ua paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit forcërisht.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1869/11 i datës 16.12.2015, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: nga Raporti i aksidentit nr.CR3004-169/11 i datës 19.05.2011, rezulton se deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti A, i vetëm duke lëvizur në rrugën magjistrale Prishtinë - Gjilan saktësisht në fshatin Parallovë në afërsi të pikës së karburanteve “Vullkan Petrol” duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës (kthesë) e humbë kontrollin

mbi automjet dhe del nga rruga në anën e djathtë të lëvizjes duke ngelur i rrotulluar jashtë rrugës, për lëndime trupore pësojnë udhëtarët si dhe shkaktohet dëm i madh material në automjet.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial dhe material, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. N.H. Neurokirurg, Dr.A.B. Kirurg torakal dhe Dr. N. M. psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë me datë 11.06.2014, kanë konstatuar se:

Paditësja L.SH. si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar lëndime trupore dhe atë: Frakturë kompresave e trupit të vertebrës Th10 dhe Th12 pa dislokim; Frakturë e trupit dhe vertebrës Th9, me dislokim të fragmenteve deri 3mm me prominim në kanal si tërësi; Frakturë serike e procesuseve transverse Th3-Th7 djathtas; Frakturë multifragmentare e procesuesit transvers Th6 djathtas; Frakturë dhe dislokim i brinjëve VII dhe VIII djathtas; Frakturë e klavikulës së djathtë; Paraparesis spastika; Ndrydhje e kokës regjioni parieto-okcipital të djathtë; Ndrydhje intrpulmonare bilateral, ku këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 2 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 7 ditëve, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 30 ditëve, dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e këtij aksidenti paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare në kohëzgjatje prej 2 minuta, frikë sekondare me intensitetit të lartë ka pasur 5 ditë, frikë sekondare të intensitetit më të ulët e ka cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 50 % duke u bazuar në tabelën për përcaktimin e shkallës së invaliditetit sipas Komunitetit Europa, pika 10 nën 3. Aktiviteti punës i është zvogëluar në shkallën prej 60%. Ndiqja e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 muaj e ka zgjatur edhe për 6 muaj të tjerë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 90 ditëve. Rehabilitimi fizioterapetik klimatik ka qenë i nevojshëm në periudhën kohore prej 30 ditësh në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas aksidentit, kurse në tri vitet vijuese edhe nga 15 ditë, për çdo vit.

Paditësja A.G., si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime trupore dhe atë: Frakturë kompresave e vertebrës L1(tip A); Frakturë e procesit transvers të vertebrës Th3-Th8; Frakturë serike e brinjëve III-IX majtas; Kontuzion hemorragjik minimal në indin pulmonar bazal më tepër majtas; Paraparez flaccide, ku këto lëndime trupore klasifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve paditësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditëve, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 20 ditëve, dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e këtij aksidenti paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare në kohëzgjatje prej 2 minuta, frikë sekondare me intensitetit të lartë ka pasur 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit më të ulët e ka cila ka zgjatur 12 muaj. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 40 % duke u bazuar në tabelën për përcaktimin e shkallës së invaliditetit sipas Komunitetit Europa, pika 10 nën 3. Aktiviteti punës i është zvogëluar në shkallën prej 50%. Ndiqja e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 muaj e ka zgjatur edhe për 3 muaj të tjerë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 60 ditëve. Rehabilitimi fizioterapetik klimatik ka qenë i nevojshëm në periudhën kohore prej 20

ditësh në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas aksidentit, kurse në tri vitet vijuese edhe nga 10 ditë, për çdo vit.

Ka shtuar se për lartësinë e dëmit material - shpenzimeve të shërimit, gjykata e ka bazuar në provat materiale - faturat e deponuara në shkresat e lëndës, ndërsa fitimin e humbur për paditësen L.SH. është bazuar në ekspertizën financiare - aktuale.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 154, 155, 178, 185, 189 dhe 200 të LMD-së, nenit 9 paragraf 1 dhe 10 të Ligjit për Sigurime të Detyrueshme nga Autopërgjegjësia, lidhur me nenin 319 paragraf 1 dhe 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata ju është referuar nenit 277 paragraf 1 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 2, 453 lidhur me nenin 463 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 366 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, për shkak se e paditura propozimit për nxjerrjen e provës me superekspertizë nga lëmia mjekësore, nuk ia ka bashkangjitur parashtrësën për të sqaruar propozimin sa i përket vërejtjeve në ekspertizë si dhe detyrave të eksperteve në superekspertizë, ku në këtë rast gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.10.2015, me aktvendim ka refuzuar propozimin e të paditurës për nxjerrjen e provës së lartpërmendur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuara në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 19.05.2011, rreth orës 17:10, në rrugën magjistrale Prishtinë - Gjilan, përkatësisht në fshatin Parallovë, në afërsi të pikës së karburanteve "Vullkan Petroll". Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit të tipit "Renault Clio" me targa të regjistrimit12, ngjyrë e kaltër, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte K.SH. nga Prishtina, e siguruar e këtu të paditurës, këtu paditëset nuk kanë kontribuar fare në shkaktimin e këtij aksidenti. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga këtu e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, pra gjatë

shqyrtimit kryesor e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditëset kanë pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se paditëset kanë përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional, nuk ka kontestuar faktin se paditësja L.SH. si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar fitim të humbur si në shumën e gjykuar me aktgjykimin e atakuar dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë. Po ashtu me nenin 180 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi i jep prova se pa fajin e vetë nuk mund ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjerë në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë ”.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëseve, gjënë mbështetje në nenin 154, 158 dhe 178 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, neni 158 përcakton se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 178 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihet në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimin i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimin të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses L.SH. është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për fitimin e humbur nga data 20.05.2011 - 31.07.2012, se bashku me kamatën, për arsye se 195 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lezionim trupor ose ja prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensoje shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast gjykata duke ju referuar kërkesës se paditësit ka lejuar që më anë të ekspertizës financiare - të aktuaristikës të bëhet llogaritja e fitimit të humbur dhe nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se fitimi i humbur për periudhën kohore nga data 20.05.2011 - 31.07.2012, është në shumën prej 4.040,67 €, ndërsa kamata është në shumën 499,20 €, pra shuma e tërësishme është prej 4.539,87 €. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, sa i përket kamatës për fitimin e humbur si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimin të atakuar, për arsye se eksperti e ka llogaritur kamatën në shkallë 3.5%, si kamatë e zbatueshme në momentin e hartimit të ekspertizës e që është në pajtim të plotë me nenin 277 të LMD-së. Gjykata e Apelit e ka pranuar fitimin e humbur duke pas parasysh ekspertizën e cila vlerësimin e ka mbështetur në rrethanën objektive për t’a

nxjerrë lartësinë e fitimit të humbur e duke ju referuar provave prezent në lëndë të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e Apelit e pranon si të besueshme, profesionale dhe të argumentuar mirë ekspertizën financiare- aktuaristikës.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet e shërimit, Gjykata e Apelit vlerësoj se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të demit gjen mbështetje në nenin 195 paragraf 1 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit ju kanë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë: dëftesë-pagesa dhe kuponët fiskal, prezent në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket demit jomaterial, për paditëset A.G. dhe L.SH. edhe atë: për dhembjet fizike, frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e), e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e demit jomaterial dhe atë: për dhembjet fizike, frikën e përjetuar dhe për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e demit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarat. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që kanë pësuar paditëset, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika te paditëset, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe rrethanat tjera, si moshën e paditësve dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 200 të LMD-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këto kategori të demit, Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk janë në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.

Aktgjykimi është ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 16.12.2015, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e saj, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tyre për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika II e dispozitivit të aktgjyqimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, nuk është shqyrtuar, sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të neneve 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 1040/16, me datë 20.06.2019

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v